

## BEQIR META

**PAKICA ETNO-KULTURORE VLEHE  
NË VITET 1912-1920**

Vllehët janë një nga pakicat etno-kulturore që shquhen për marrëdhëniet më të ngrohta me popullsinë shqiptare dhe përbëjnë një model të shkëlqyer historik të bashkëjetesës harmonike.

Për këtë pakicë nuk ka shumë informacion mbi shtrirjen dhe gjendjen e saj në këtë periudhë të parë të turbullt të historisë pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Sidoqoftë për numrin e arumunëve në prag të pavarësisë së Shqipërisë kemi dy burime relativisht më të besueshme. Në fund të shekullit XIX Weigand jepte shifrën e rreth 17000 vllahëve për territoret në Shqipërinë e sotme politike.<sup>1</sup> Mjaft të ekuilibruara dhe ndofta më të besueshmet mund të konsiderohen burimet zyrtare turke. Statistikat turke të vitit 1908 për Kazanë e Korçës japin shifrën 1544 ortodoksë vllahofonë.<sup>2</sup>

Për periudhën në studim, disa të dhëna të pjesshme por të sakta jepte regjistrimi i popullsisë që u bë me porosi të ushtrisë austro-hungareze në vitin 1918. Ai u krye nga oficerët austriakë me bashkëpunimin e shqiptarëve, që e njihnin vendin dhe që më së shumti ishin njerëz të arsimuar. Numërimi i popullsisë u krye vetëm në viset që ndodheshin nën pushtimin austriak, të cilat kapnin një sipërfaqe prej 20.096 km<sup>2</sup> me një popullsi 524.217 banorë. Mbeti jashtë regjistrimit Korça, Gjirokastra, Vlora etj<sup>3</sup>. Po japim një tabelë të dhënave të këtij regjistrimi:

<b>Krahina</b>	<b>Shqiptarë</b>	<b>Vllahë</b>	<b>Serbë</b>	<b>Bullgarë</b>	<b>Grekë</b>	<b>Jevgj</b>
Rrethi Mat	23.763	40	-	-	-	208
Rrethi Krujë	19.627	-	-	-	-	182
Rrethi Ohër	7.921	-	-	-	-	45
Rrethi Pukë	14.805	-	-	-	-	18
Rrethi Oroshi	17.679	-	-	-	-	-
Rrethi Kiri	12.896	-	-	-	-	-
Rrethi i Lezhës	12.955	1	1	-	5	104

<sup>1</sup> Gustav Weigand, *Die Aromunen-Ethnographisch-Philologisch-Historische Untersuchungen*, Leipzig: 1895.

<sup>2</sup> Demetre Kolovani, *La Question de Koritza*, Paris: 1916, f. 19.

<sup>3</sup> Franz Seiner, *Numërimi i parë i popullsisë në Shqypni*, Shkodër: 1922.

Malësi e Madhe	13.555	-	80	-	-	-
Shkodër	39.551	1	1.595	5	10	562
Durrës	20.329	538	-	-	14	860
Elbasani	27.709	-	-	1	-	1.004
Kavaja	17.403	-	1	-	-	371
Peqini	7.928	-	-	-	-	311
Tirana	33.368	1	23	1	-	1.178
Dibra e Poshtme	39.210	96	13	206	1	453
Gora	8.162	-	5	-	-	12
Hasi	11.163	-	4	-	-	69
Luma	16.222	3	4	-	-	92
Malësi e Gjakovës	14.076	-	-	-	-	92
<b>Zona poshtë Tiranës</b>						
Berati – s'ka të dhëna						
Fieri – s'ka të dhëna						
Lushnja - s'ka të dhëna						
Mallakastra	24.268	70	-	-	2	67
Skrapari	10.883	-	-	-	-	154
Elbasani i Poshtëm	9.580	-	-	-	-	56
Gramshi	2.909	-	-	-	-	9

Shifra totale e vllhëve ishte 750

Në prag të Konferencës së Londrës së vitit 1913, një delegacion i Shoqërisë Kulturore Maqedono-Rumune të Bukureshtit, i përbërë nga Prof. George Murnu, Prof. N.A Papahagi, Prof. Juliu Valaori, shkoi në kryeqytetin britanik për të mbrojtur çështjen e një Maqedonie autonome. Mirëpo projekti i Maqedonisë autonome nuk përkrahej nga Fuqitë e Mëdha.<sup>4</sup>

Duke parë rrezikun që u kanosej arumunëve, edhe qeveria e Bukureshtit ndërmori një aksion energjik në Konferencën e Londrës. Ajo kërkoi që, kur të caktoheshin kufijtë natyralë të shtetit të ardhshëm shqiptar, grupi kryesor i rumunëve që banonin midis Gramozit e Manastirit të përfshiheshin brenda tij në formën e një province autonome. Këtë fakt e vinte në dukje më vonë edhe një deputet rumun, I. Gradishteau, i cili deklaroi në Parlamentin rumun “ se në vitin 1913 qeveria rumune bëri ç'mundi që të krijohej një Shqipëri sa më e madhe, e cila të përmbledhte sa më shumë rumunë nga gadishulli Ballkanik”. Sipas tij, këtë gjë e dëshmonte qartë Libri i Gjellbër rumun i viteve 1912-1913. Gjithashtu Gradishteau pohonte se Rumania, e gjendur para verdiktit të Evropës, u nxitua ta njëhte shtetin shqiptar ashtu siç ishte. Por ai vinte në dukje

<sup>4</sup> *Sguardo retrospettivo sul Movimento Nazionale dei Macedo-Romeni nella Penisola Balcanica*, Bucarest: shtator 1940, f.13.

edhe qëndrimin pasiv dhe të ftohtë të Rumanisë ndaj shtetit të rimëkëmbur shqiptar pas Luftës së I Botërore<sup>5</sup>.

Qeveria greke kërkoi që arumunët e Pindit të qëndronin në shtetin grek dhe jo në atë shqiptar, duke premtuar se Greqia do t'u jepte garanci për ruajtjen e identitetit të tyre etnik<sup>6</sup>. Të njëjtin premtim bëri edhe Serbia. Edhe Traktati i Paqes i Bukureshtit i vitit 1913 i cili pasoi Luftën e II Ballkanike, përcaktonte që të dy shtetet (Greqia e Serbia) do binin dakord që t'i jepnin autonomi shkollave dhe kishave maqedono-rumune dhe për krijimin e një peshkopate rumune. Nëse qeveria rumune dëshironte të subvenciononte institucionet kulturore ekzistuese që drejtoheshin nga arumunët, shtetet e lartpërmendura nuk do ta pengonin<sup>7</sup>.

Por këto angazhime nuk u respektuan kurrë. Qysh në vitin 1913 bandat e armatosura greke, të njohura me emrin "ierolohiti" (kompanitë e shenjta), hynë në Shqipërinë e Jugut, duke masakruar kryetarin e komunitetit arumun Harallamb Ballamaçin dhe të gjithë anëtarët e Komitetit Rumun të Korçës. Të njëjtën gjë pësoi edhe D. Cicna, i cili ishte njëri ndër drejtuesit e lëvizjes nacionaliste arumune<sup>8</sup>. Edhe ata maqedono-rumunë që u futën në kufijtë e shtetit bullgar nuk patën një fat më të mirë. Shumë intelektualë dhe krerë të komunitetit u internuan nga autoritetet bullgare dhe atyre iu bë një trajtim shumë barbar.

Studiues dhe shkrimtarë të ndryshëm italianë e mbështetën me forcë çështjen arumune. Ata i bënë thirrje qeverisë italiane të merrte masa energjike në përkrahje të tyre. De Luca shkruante atëherë se arumunët ose kuçovllehët, që përbënin në këto rajone një aneks të popullsisë shqiptare, duhej të mbroheshin prej Romës, e cila duhej të ndërhynte në favor të "kolonive të sajë të vjetra perandorake" dhe të përpiqej të përfitonte në koncertin evropian ose në mosmarrëveshjet e në rrëmujën evropiane për të mbrojtur të drejtat e tyre<sup>9</sup>. Ai shprehte shqetësimin se, nëse problemi nuk do të zgjidhej shpejt, "nesër kur të konsolidohen shtetet ballkanike përfundimisht në këto rajone, zhdukja e elementit arumun të Turqisë Evropiane do të jetë çështje vitesh". Ai bënte thirrje të mos përsëriteshin gabimet e mëparshme që kishin mohuar kombësinë, por "që sot, duhej ndërhyrë për të krijuar një regjim midis fitimtarëve të sotëm dhe të shtypurve të mundshëm të nesërm të Evropës, i cili të siguronte

<sup>5</sup> "Interpelanca e I.Gradishteanut në Dhomën e Deputetëve të Rumanisë", botuar në gazetën *Shqipëria e Re*, 18 maj 1924.

<sup>6</sup> *Sguardo Retrospectivo...*, f.14. Autorët i referohen një telegrami të ministrit të Rumanisë në Londër dërguar MPJ të Rumanisë, Londër 2/15 qershor 1913.

<sup>7</sup> *Po aty*.

<sup>8</sup> *Po aty*, f.15.

<sup>9</sup> Benedetto De Luca, *Gli Albanesi i Macedo-Romeni e gli interessi d'Italia nei Balcani*, Roma: 1913, f.18.

zhvillimin e lirë dhe paqësor të gjithë këtyre kombeve të ndryshme”. Në të kundërt nuk do të kishte paqe të vërtetë në Ballkan, sepse shqiptarët dhe arumunët, që ishin elementët më të vjetër e më të vlefshëm të Turqisë Evropiane, do të zhdukeshin nga harta etnografike e Maqedonisë nëpërmjet një lufte të pamëshirshme<sup>10</sup>.

Në të vërtetë, të dy popujt ishin më të kërcënuarit në këto momente. Prandaj elementë të veçantë dhe organizata të ndryshme bënë një agjitacion për bashkëpunimin e tyre. Kështu, në një gazetë të Bukureshtit, më 14 nëntor 1913, u publikua një deklaratë e një komiteti shqiptaro-arumun, në të cilën formulohej postulati se “shqiptarët dhe arumunët e Maqedonisë, duke i falënderuar Aleatët Ballkanikë për lirinë që u dhanë atyre, deklarojnë se nuk dëshirojnë të bien nën sundimin e çlirimtarëve të cilët do t’i privonin ata nga një e drejtë tjetër e çmueshme për ekzistencën e tyre etnike - nga gjuha amtare. Njëfarë autonomie shkollore, që ata na akordojnë, nuk e pengon procesin e shkombëtarizimit nga e ana e popujve të tillë si serbët, bullgarët e veçanërisht nga grekët”<sup>11</sup>.

Në këtë deklaratë arumunët kërkonin “të drejtën e jetës kombëtare në territoret, të cilat i banonin qysh prej antikitetit, mbi të cilat “kishin të drejta të papërshtueshme”. Ata kërkonin “një jetë të pavarur, qoftë në formën e një shteti maqedono-shqiptar, qoftë në formën e dy shteteve : Maqedonisë dhe Shqipërisë, në të cilat të gjitha kombet të gëzonin të drejta të barabarta, të ruanin gjuhën e tyre nën kontrollin e Evropës”<sup>12</sup>. Ata e cilësonin këtë zgjidhje si një avantazh për ruajtjen e ekuilibrit ballkanik i cili ishte i dëmtuar nga pushtimet territoriale të katër shteteve aleate të Ballkanit.

Ka pasur vazhdimisht dy rryma të mendimit vllëh. Një pjesë e vllëhëve të shpërndarë në Maqedoni ëndërronte krijimin e një Vllahie të Madhe ndërsa një pjesë tjetër, kërkonte të bashkohej me Shqipërinë për t’u shpëputur prej sundimit grek<sup>13</sup>. Lidhur me këtë E. Durham shkruante se “vllëhët që banojnë në Elbasan, në rrethinat e tij si dhe gjetkë, e që përbëjnë një numër të konsiderueshëm, janë të gjithë për pavarësinë e Shqipërisë”<sup>14</sup>. Të njëjtat ndjenja ushqenin edhe shqiptarët për vllëhët dhe E. Durham shkruante: “Shqiptari dhe vllahu u takuan si vëllezër. Vllëhët janë si ne”, më tha një shqiptar një herë: “Njeriu e marton vajzën pa frikë me një vllëh; kurse sllavi është ndryshe, i thartë, fund e krye”<sup>15</sup>.

<sup>10</sup> *Po aty*, f.36.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> “I diritti dell’Albania”, *Kuvendi*, 10 mars 1919.

<sup>14</sup> Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Tiranë: Shtëpia botuese “8 Nëntori”, 1990, f. 82.

<sup>15</sup> *Po aty*, f. 191.

Pikërisht në vitin 1912, kucovllehët e Plasës dëbuan priftin dhe mësuesin grek nga katundi me qëllim që të krijonin kishën dhe shkollën e tyre. Mitropoliti grek i Korçës, me anë të të hollave që i dha Konsulli grek i Manastirit, e bindi bimbashin turk që ta shoqëronte me xhandarë në Plasë për të rivendosur shkollën e kishën greke. Por vllahët e Plasës e kundërshtuan vajtjen e Dhespotit duke dalë jashtë katundit dhe duke e goditur me gurë. Kështu, dhespoti nuk mundi të hyjë në katund dhe u kthye në Korçë. Ai dha urdhër që t'u binin kambanave të kishave. Një pjesë e popullsisë mbylli dyqanet dhe u sul në kishë. Me këtë veprim, komitetet greke deshën të tregonin forcën e tyre dhe ta kërcënonin Mytesarifin e Korçës me kryengritje, sepse ky ishte kundërshtar i grekomanëve dhe kishte marrëdhënie të mira me shqiptarët dhe vllahët.<sup>16</sup>

Dëshmi interesante rreth përpjekjeve të grekëve për asimilimin e vllahëve e të shqiptarëve jepte Edit'h Durhami e cila shkruante se, kur kishte vizituar Voskopojën në verën e vitit 1912, "autoritetet greke na përgatitën një skenë të çuditshme. Ata kishin dërguar këtu për tërë natën një numër njerëzish që na pritën duke hedhur valle. Si në një skenë teatrale, ata thërrisnin greqisht: "mirëserdhët në qytetin tonë"! Në të vërtetë qyteti banohej prej vllahëve dhe shqiptarëve. Ekipi që na shoqëronte kudo kishte për qëllim që të mos na linte vetëm për të mos mësuar të vërtetën. Ishte e qartë se ata, nga lëvizjet dhe qëndrimet e tyre, dukeshin se ishin të porsaardhur në këtë qytet. Duke kaluar rrugës dëgjuaam njërin që i foli shqip një gruaje. E pyetëm se si e kishte mësuar shqipen. Na tha se "e kam nga nëna". Atëherë qenkeni gjysmë shqiptar, i thashë. "Jo", m'u përgjigj mjaft i shqetësuar, "Nëna ime ishte greke, por kur ishte e re, këtu s'kishte akoma shkolla greke. Kështu që e gjora dinte vetëm shqip se nuk pati rastin të flasë kurrë gjuhën e saj të vërtetë". Kjo s'ishte gjë tjetër, veçse propagandë greke"<sup>17</sup>.

Në momentet e para, pasi shqiptarët kishin shpallur pavarësinë e tyre dhe po përpiqeshin për afirmimin e saj në arenën ndërkombëtare, doli në pah edhe problemi i pozitës së vllahëve të Shqipërisë. Në Konferencën e Londrës, delegati i Rumanisë propozoi që vllahët e Pindit t'i aneksoheshin Shqipërisë, sepse në këtë mënyrë mund të rronin në miqësi dhe në marrëdhënie të mira. Por, siç pohonte Mehdi Frashëri në Gjyqin e Hagës, pas Luftës së Dytë Ballkanike, Venezelloi, me zgjuarsin, iu zotua qeverisë rumune se vllahëve që do të hynin nën zotërimin e Greqisë do t'u garantoheshin të drejtat e pakicave, sidomos e drejta që të kishin shkollat e tyre.

Në Luftën e Dytë Ballkanike, Rumania u bë aleat i shteteve të tjera ballkanike dhe luftoi kundër Bullgarisë. Ndoshta kjo ngjarje politike e rëndësishme ndryshoi qëndrimin e delegacionit rumun. Megjithatë pas kësaj

<sup>16</sup> "Lëvizja shqiptare në Korçë", *Atdheu*, Kostancë, 13 gusht 1913.

<sup>17</sup> Edith Durham, *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*, Tiranë: "Argeta-LMG", 2001, f. 280.

ngjarje, pati një moment kur persekutimi shpirtëror kundër arumunëve nga ana e Patriarkanës dhe nga ana e komiteteve greke në Maqedoni, në Shqipëri dhe në Thrakë, arriti në atë shkallë sa shkaktoi ndërprerjen e marrëdhënieve midis Greqisë dhe Rumanisë<sup>18</sup>.

Ndryshe nga fati i vllhëve që mbetën në shtetet ballkanike, në Shqipëri nuk pati asnjë politikë asimiluese ndaj tyre. Kjo lidhej si me gjendjen e shtetit shqiptar në këtë periudhë ashtu edhe me natyrën e përgjithshme tolerante e miqësore të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe vllhëve. Megjithatë pati edhe raste replikash e debatesh midis dy palëve veçanërisht kur u shfaq ndonjë kërkesë maksimale dhe jo realiste. Një debat interesant, por që mbeti në kuadrin e miqësisë shqiptaro-vllehe, u zhvillua në Kongresin e Trieshtit. Në këtë kongres morën pjesë edhe disa delegatë vllh, Epaminonda Ballamaçi, At Foti Ballamaçi, Dr. Shunda etj. Edhe në këtë kongres, delegatët vllh, që të gjithë, rikonfirmuan dëshirën e tyre për të mbetur në kuadër të shtetit shqiptar. Ata evokuan dhe ngritën lart miqësinë tradicionale shqiptaro-vllehe<sup>19</sup>. Gjithashtu, me propozimin e delegatëve vllh, kongresi shprehu ndjenja të zjarra miqësore për Mbretin dhe qeverinë rumune, për Italinë dhe Austro-Hungarinë.

Mirëpo në kongres u shfaqën edhe disa divergjenca kur një pjesë e delegatëve arumunë shfaqën kërkesa maksimaliste. Ata kërkuan që kongresi të cilësohej si një kongres shqiptaro-rumun. Kjo kërkesë u kundërshtua nga delegati i shqiptarëve të Konstancës, Mihal Lehova, i cili theksoi, se kongresi ishte thjesht shqiptar dhe punonte për Shqipërinë. Kështu në telegramet që do t'u adresonte ai Fuqive të Mëdha të cilësohej si një kongres shqiptar dhe të mos i jepej kongresit një fytyrë shqiptaro-vllehe, por një fytyrë thjesht shqiptare. Ky propozim u pranua gjerësisht dhe, pas shumë diskutimesh, u vendos që telegrami të formulohej si më poshtë: shqiptarët, mbledhur në kongres në Trieste, përfaqësues të tërë viseve të Shqipërisë dhe nga ana e kolonive shqiptare..., vendosën me aklamacion të përgjithshëm t'i shfaqin ekselencës suaj ngjatjetimet e tyre të zemrës për mirëdashjen e lartë dhe për përkrahjen që i keni dhënë atdheut të tyre. Dhe vllhët që qenë të pranishëm në këtë kongres bashkohen me këto ngjatjetime<sup>20</sup>.

Përfaqësuesi i vllhëve të Amerikës, Dr. Patagjo propozoi që kongresi t'u lutej Perandorit të Austrisë, Mbretit të Italisë dhe të Rumanisë, që të përkrahnin Shqipërinë, për të bashkuar të katër vilajetet nën flamurin e saj. Ky propozim u prit me ovacione nga kongresi, ku shpërthyen thirrjet "Rroftë Shqipëria e Madhe". Mirëpo, në këtë moment, At Foti Ballamaçi, pasi bëri një historik, në

<sup>18</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1935, dos.77, Diskutimi i Mehdi Frashërit në seancën e Gjykatës së Hagës, më 12 mars 1935; *Besa*, 9 maj 1935.

<sup>19</sup> "Kongresi Shqiptar i Triestit", *Atdheu*, 25 shkurt 1913.

<sup>20</sup> *Po aty*.

të cilin nënvizohet bashkëjetesa në harmoni e paqe e shqiptarëve dhe vllëhëve, kërkoi që shteti i ri shqiptar t'u jepte autonominë territoriale vllëhëve.<sup>21</sup> Më tej, Dimitri Skadima kërkoi që kjo autonomi të ishte si ajo e çekëve të Austro-Hungarisë. Edhe Dr.Shunda, pasi ngriti lart miqësinë dhe dashurinë reciproke dhe pa asnjë incident midis shqiptarëve dhe vllëhëve, propozoi që, nga pikëpamja administrative, Shqipëria të pranonte për vllëhët një sistem si ai i Austrisë.

Edhe delegatët e tjerë vllëhë e përkrahën propozimin për “autonominë territoriale”<sup>22</sup>. Por këtë kërkesë e kundërshtoi përsëri avokati M. Lehova, i cili theksoi se kongresi kishte si qëllim t'u kërkonte Fuqive të Mëdha t'i jepnin fund sa më shpejt caktimit të kufijve të Shqipërisë dhe nuk kishte fuqi që ta diskutonte këtë çështje. Këto diskutime mund të bëheshin në një parlament ose në një këshill kombëtar. Ai vuri në dukje se vllëhët në Shqipëri nuk formonin masa kompakte që të formonin kantone si në Zvicër. Të tilla zona kishte në vilajetin e Manastirit i cili ishte i pushtuar prej serbëve dhe grekëve. Disa delegatë vllëhë pretenduan se një masë kompakte vllëhësh ndodhej në Fushën e Myzeqesë. Mirëpo, këtë pohim e kundërshtoi Izet Bej Vrioni i cili kishte çifligjet e tij në Myzeqe. Ai tha se në këtë zonë nuk kishte fshatra të pastra, të banuara nga vllëhët, por kishte vetëm disa fshatra të banuara nga vllëhë dhe shqiptarë. Të njëjtën gjë pohoi dhe delegati vllëh nga Berati, Petro Goxhomani i cili tha: “Unë jam vllah dhe e njoh mirë fushën e Myzeqesë. Mund të them se atje ku janë vllëhët nuk janë tokicë (masë kompakte) siç besojnë njerëzia që s'kanë vajtur të shohin me sytë e tyre dhe kanë dëgjuar për vllëhët prej së largu. Sa për vllëhët e Shqipërisë mund t'u them se janë të shqiptarizuar dhe e flasin shqipen më shumë se vllahishten dhe shumë prej tyre e kanë humbur gjuhën e vet tërësisht”<sup>23</sup>.

Për të kundërshtuar këtë deklaratë, delegati vllah Diamandi paraqiti një hartë në të cilën paraqiteshin vllëhët në Maqedoni dhe pretendohet se ekzistonin zona, ku vllëhët ishin një masë kompakte. Në këtë çast u dëgjua një zë nga salla, i cili tha: “Grekët kanë hartën e tyre me Shqipërinë greke, serbët me Stara Serbinë, atëherë ku është Shqipëria? Apo duan të na bëjnë shtet mbi shtet! Kjo u përkrah me brohoritje nga salla dhe kështu morën fund bisedimet e ditës së katërt të kongresit mbi çështjen e vllëhëve. Kryetari i kongresit i mbylli diskutimet duke deklaruar se “Shqipëria do të ketë zakone mjaft të lira dhe të gjithë qytetarët e shtetit shqiptar do të kenë të drejta të barabarta”<sup>24</sup>.

Megjithëse Kongresi i Trieshtit kaloi në një frymë miqësore, një krah i nacionalistëve vllëhë mbeti i pakënaqur prej tij dhe prej dështimit të kërkesave

---

<sup>21</sup> *Po aty.*

<sup>22</sup> *Po aty.*

<sup>23</sup> *Po aty.*

<sup>24</sup> *Po aty.*

të tyre maksimaliste. Për këtë arsye vllahët e Maqedonisë themeluan një shoqëri shqiptaro-vllehe, domethënë një shoqëri të vllahëve të Shqipërisë në Bukuresht<sup>25</sup>. Kjo shoqëri, në mbledhjen e saj të parë, të kryesuar nga At Foti Ballamaçi, shpalli se synonte të mbronte individualitetin kombëtar të vllahëve të Shqipërisë. Shoqëria shfaqti shqetësimin për “gjendjen e tyre të kombësisë” në shtetin e ri shqiptar, që po themelohej, e cila do të ishte në rrezik. Shoqëria propozonte që “të kundërshtohet me rrugë të qytetëruara fryma reaksionare e shoviniste e cila do t’i sjellë dëme shtetit shqiptar dhe do të ndjehet e kënaqur, po të mund të mbrojtë dhe të përhapë, lidhjen e bashkimit e mirëkuptimit midis popullit shqiptar dhe popullit vllah, duke pasur parasysh bashkëpunimin e patundshëm dhe duke e forcuar atë me njohjen njëri-tjetrit të qenies kombëtare në Shqipëri”.<sup>26</sup> Ajo kërkonte që shteti shqiptar duhej të ndryshonte prej gjithë shteteve të Ballkanit, të cilat gjer në këtë kohë ishin treguar shoviniste, duke shtypur popullin vllah dhe popullin shqiptar. Kjo politikë do të ishte në nderin e tij.

Themelimi i shoqërisë ishte bërë me iniciativën e Dr. Shundës dhe deklarohet se ajo ishte formuar për të qenë e përgatitur për ngjarjet që mund të ndodhnin në Gadishullin e Ballkanit dhe veçanërisht në shtetin e ri shqiptar. Shoqëria shprehte pakënaqësinë sepse, sapo filloi të krijohet shteti shqiptar dhe u formua një qeveri provizore në Vlorë, “disa koka të ndezura u larguan prej atyre lidhjeve të moçme të miqësisë midis shqiptarëve dhe vllahëve, duke treguar fanatizmin dhe shovinizmin dhe duke propaganduar frymën e intolerancës kundrejt popullit vllah të Shqipërisë dhe ndaj të drejtave të tij natyrale të jetës kombëtare përkrah kombit shqiptar”<sup>27</sup>. Drejtuesit e saj deklarorin se këto arsye i kishin shtyrë që të krijonin këtë shoqëri dhe të merrnin masa të shpejta që të mbronin individualitetin e “kombit” të tyre në Shqipëri. Arsye tjetër konsiderohej Kongresi i Trieshtit, në të cilin thuhej se mbizotëroi “fryma e intolerancës e cila dëftoi se shqiptarët përfaqësojnë tërë elementet etnike prej truallit të tyre dhe atë gjyq e numërojnë sipas fuqisë së shumicës dhe në bazë të shumicës aritmetike”. Shoqëria vllahë deklaronte se “neve shqiptaro-vllahët jemi të bindur se e drejta është në anën tonë dhe prandaj po organizojmë këtë shoqëri të gatuar në frymë demokratike. Shoqëria angazhohej që të ndihmonte djalërinë vllahë të Shqipërisë të stërviste mendjen, zemrën dhe personalitetin e saj, zhvillimin e vetëdijes së popullit të saj. Shoqëria pretendonte se do të ndryshonte prej frymës oligarkike dhe despotike që, për fat të keq, ishte rrënjësuar në disa shoqëri të tjera të arumunëve. Duke punuar për të formuar vllah patriotë të mirë, shoqëria vllahë shprehte bindjen në triumfin e drejtësisë dhe të mirësisë në Shqipërinë e re, konstitucionale e

<sup>25</sup> *Atdheu*, Konstancë, 12 prill 1913.

<sup>26</sup> *Po aty*.

<sup>27</sup> *Po aty*.

evropiane<sup>28</sup>. Shoqëria vllehe pranoi propozimin e avokatit Çeako Gjorgji, një anëtar i parisë së shoqërisë vllehe të Stambollit, që vllhët e Shqipërisë (shqiptaro-vllhët) të luftonin për pranimin e gjuhës vllehe si gjuhë zyrtare të shtetit shqiptar. Me justifikimin se gjuha shqipe nuk ishte e zhvilluar dhe se shqiptarët kishin motive serioze e të forta që të preferonin gjuhën vllehe<sup>29</sup>.

Pretendimet e shoqërisë vllehe ngjallën pakënaqësi në koloninë shqiptare të Rumanisë. Gazeta Atdheu e Konstancës shprehte habinë se si shoqëria e kishte cilësuar Kongresin e Trieshtit një mbledhje të mbajtur me një frymë reaksionare të shqiptarëve, sepse në këtë kongres delegatët arumunë ishin pritur mirë dhe me dashuri të madhe prej tërë delegatëve shqiptarë. Gazeta afirmonte se në Shqipërinë e re vllhët do të gëzonin të drejta të barabarta me qytetarët shqiptarë, do të kishin kishat, shkollat e gjuhën e tyre, të cilat nuk do t'i kishin në Serbi dhe në Greqi. Pastaj gazeta, duke kritikuar qëndrimet fyese të shoqërisë vllehe ndaj atdhetarëve shqiptarë, shkruante se, “kur këta shqiptarë, në kohën e xhonturqve, punonin e luftonin për të krijuar një Shqipëri më vete, kur ata, që sot quhen fanatikë dhe reaksionarë, ndiqeshin nga qeveria turke për idenë kombëtare dhe mbylleshin nëpër burgje, atëherë asnjëri nga ata që sot thërrasin se shqiptarët janë reaksionarë nuk u bashkua me ne por ishin miqtë e xhonturqve dhe punonin kundër kombit shqiptar<sup>30</sup>. Në të vërtetë kjo ishte një përgjigje emocionale pasi në këtë fazë përveç disa vllhëve grekomanë apo turkofilë pati edhe shumë vllhë që e ndihmuan çështjen kombëtare shqiptare. Gazeta cilësonte si reaksionarë dhe nacionalistë ata vllhë të cilët kërkonin që gjuha vllehe të bëhej gjuhë zyrtare e shtetit të ri shqiptar. “Kush janë oligarkistë – shkruante Atdheu – shqiptarët, apo ata që punojnë për të bërë një shtet mbi shtet, në një shtet të ri dhe të vogël i cili ende nuk ka arritur gjendjen e shteteve që të mund të përparojnë dhe të përmbushin idealin kombëtar të një shteti?”. Pastaj gazeta e lartpërmendur shtronte pyetjen: “A është dëgjuar ndonjëherë në botë që një komb, i cili ka gjuhën e tij, të përdorë një gjuhë të huaj?”<sup>31</sup>.

Atdheu u përgjigjej edhe vllhëve të Maqedonisë duke argumentuar se individualiteti etnik i vllhëve të Shqipërisë nuk ishte i kërcënuar por, përkundrazi, i kërcënuar ishte identiteti i vllhëve të Maqedonisë, të cilët, pas disa viteve, rrezikoheshin të serbizoheshin dhe të greqizoheshin, pasi atje “nisi dhe do të jetë reaksioni dhe oligarkia, atje nuk do t'i lejonin të quheshin vllhë dhe të mbronin individualitetin kombëtar. Ndërsa në Shqipëri askush nuk do të mendonte t’ia mohonte popullsisë vllehe përparimin e mbrothësimin në gjuhën e vet. Kjo pakicë do të kishte të drejta të plota si dhe populli shqiptar<sup>32</sup>.

<sup>28</sup> *Po aty.*

<sup>29</sup> *Po aty.*

<sup>30</sup> *Po aty.*

<sup>31</sup> *Po aty.*

<sup>32</sup> *Po aty.*

Disa ditë më vonë, në një artikull tjetër, gazeta *Atdheu* i konsideroi propozimet e lartpërmendura të disa qarqeve vllehe të Maqedonisë si joserioze, të cilat kishin rrezik të minonin besimin e popullit shqiptar tek pakica vllehe dhe do t'i sillnin dëmin më të madh afirmimit të identitetit të vllehëve. Gazeta shprehte besimin se këto kërkesa, për të krijuar një shtet mbi shtet, nuk do të gjenin mbështetje as tek vllahët e Shqipërisë dhe as tek qeveria rumune e cila duhej të përkrahte forcimin e shtetit shqiptar për të ruajtur ekuilibrin në Ballkan<sup>33</sup>.

Por, përveç gazetës *Atdheu*, pati edhe ndonjë reagim tjetër me një frymë edhe më të ashpër nacionaliste. “Gazeta Liri e Shqipërisë” kritikoi organizatorët e Kongresit të Triestit se kishin bërë një gabim që kishin ftuar në këtë kongres kucovllahët, “të cilët, pa turp, kërkuan që kongresi të emërohej shqiptaro-vlleh. “Sa çudi – shkruante gazeta, - kur një grusht kucovllehesh që gjenden në Shqipëri, kur qenia apo mosqenia e tyre s’ka asnjë rëndësi politike, as ndonjë vleftë ekonomike, u ftuan në kongres dhe kjo na bëri pikë në zemër sepse e dinim bukur se çdo të kërkonin”<sup>34</sup>. Haki Glina shkruante se “kucovllehtë janë njerëz pa ide të shquara, janë të varfër nga karakteri kombëtar dhe nuk e dinë se nga u vjen e mira dhe e liga. Ai nënvizonte se disa kucovllehë, që gjer dje s’mund ta mendonin se do të bënin propagandë, të cilët pa turp e pa frikë perëndie na këshillonin të merrnim shkronjat arabe dhe dëshironin humbjen tonë”<sup>35</sup>, tashmë po përpiqeshin të ndryshonin karakterin kombëtar të shtetit shqiptar. Ai u kujtonte atyre se rreziku vinte prej serbëve e grekëve dhe shembulli më i mirë për këtë ishin vllahët e Fushës së Thesalisë, të cilët ishin greqizuar dhe nuk duhej të kërkonin në kongresin shqiptar autonomi territoriale, sepse ky kongres nuk kishte të drejtë të diskutonte “propozimet pa kripë të barinjve”. Glina denonconte presionin që po i bënin vllahët qeverisë rumune për të dëbuar shqiptarët e Rumanisë dhe avokatin Mihal Lehoval të cilët kishin kundërshtuar hapur kërkesat ekstremiste të tyre. Ai vinte në dukje se kucovllehët e Shqipërisë, që merreshin më së shumti me blegtori, të cilën e mbarështronin së bashku me shqiptarët, kurrë nuk dëshironin të ndaheshin prej kombit shqiptar. Ndërsa kucovllehët si Dr. Shunda me shokë, ashtu siç ishin vënë dikur në shërbim të xhonturqve dhe kishin përndjekur shqiptarët, po këshillonin qeverinë rumune që të vepronte në të njëjtën mënyrë<sup>36</sup>.

Propozime më të moderuara pati nga personalitete të jetës politike e intelektuale rumune. Senatori dhe profesori, Isopesku Grekul nënvizonte se zgjidhja ishte një Maqedoni autonome, sepse Maqedonia nuk ishte as serbe, as

<sup>33</sup> “Gjuha zyrtare në Shqipëri”, *Atdheu*, Kostancë, 28 prill 1913.

<sup>34</sup> Haki Glina, “Kucovllehtë me ca shqiptarë të poshtër”, *Liri e Shqipërisë*, Sofje, 11 prill 1913.

<sup>35</sup> *Po aty*.

<sup>36</sup> *Po aty*.

greke e as bullgare, as shqiptare dhe as vllehe, por një përzierje e këtyre popujve. Ai kishte qenë përkrahës i idesë së krijimit të një shteti të pavarur shqiptar, sepse besonte që shqiptarët mund të bashkëjetonin në harmoni me vllahët. Ai, gjithashtu, shprehte shqetësimin se shqiptarët dhe vllahët, që jetonin në viset e aneksuara nga Greqia, si Janina do të shkombëtarizoheshin prej grekeve. Grekuli propozonte gjithashtu krijimin e një Mitropolie shqiptaro-vllehe në Shqipëri, e cila do të kishte të drejtë të kujdesej për pakicat shqiptare dhe vllehe që do të mbeteshin në shtetet e Ballkanit<sup>37</sup>.

Qeveria shqiptare e periudhës së Princ Vidit, edhe pse ekzistoi në një periudhë të vështirë dhe të shkurtër kohore, u përpoq që të kujdesej për vllahët e Shqipërisë. Prefektura e Korçës kërkoi në maj të vitit 1914 të protestohet dhe të merreshin masat e duhura që të hiqeshin pengesat që po u krijonte qeveria greke blegtorëve vllahë për t'u kthyer në viset shqiptare pas periudhës së dimërimit të bagëtive në Greqi<sup>38</sup>.

Gjatë Luftës së I Botërore arumunët e Maqedonisë e të Pindit ndihmuan Fuqitë e Antantës në prapavijat në frontin e Selanikut. Në vitin 1917 trupat italiane pushtuan Pindin dhe hynë në rajonin e Zagorisë, i cili banohej në masë dërmuese nga arumunët. Ata u pritën me brohoritje dhe me parullat: “Rroftë Italia!”, “Rroftë Roma e pavdekshme!”. Kryetarët e të gjitha komuniteteve arumune të Pindit e të Zagorisë u mbledhën në një kongres të madh në qytetin e Samarinës i cili zgjodhi një Këshill Nacional si kreun e Republikës së Rumunëve të Pindit e Zagorit<sup>39</sup>.

Por Republika e Pindit nuk e pati jetën të gjatë. Trupat italiane u tërhoqën nga ky rajon dhe këtë tërheqje e pasuan persekutimet më të tmerrshme kundër arumunëve, megjithëse më parë ishte arritur një marrëveshje midis komandantit të forcave italiane dhe autoriteteve greke, e cila parashikonte që krerët arumunë, të cilët kishin manifestuar mbështetjen për Italinë, nuk do të keqtrajtoheshin e të dënoheshin. Anëtarët e Këshillit Kombëtar kaluan muaj të tërë në burg në ishullin e Zakintos. Për muaj të tërë, maqedo-rumunët e Pindit e të Zagorit ju nënshtruan një regjimi terrori.<sup>40</sup>

Në qershor të vitit 1917 qeveria italiane i kërkoi qeverisë rumune që të dërgonte vllahë në Maqedoni dhe në Epir për të zhvilluar propagandë antigreke por rumunët refuzuan<sup>41</sup>. Italianët ishin mbështetësit kryesorë të vllahëve në Konferencën e Versajës por mbështetja e tyre ishte e pamjaftueshme. Rumania,

<sup>37</sup> *Atdheu*, Konstancë, 12 maj 1913.

<sup>38</sup> *AMPJ*, viti 1914, dos.52, fl. 2, Prefekti i Korçës për MPB, 19 maj 1914.

<sup>39</sup> *Sguardo Retrospectivo...*, f.15.

<sup>40</sup> *Po aty*.

<sup>41</sup> N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference of Paris, 1919*, Thessalonica: “Institute for Balcan Studies”, 1978.

që kishte probleme më të mprehta në afërsi të saj dhe ishte e preokupuar për të qenë në marrëdhënie të mira me të gjithë, nuk e mbështeti me energji çështjen vllehe.

Shumë vonë maqedo-rumunët dërguan në Konferencën e Paqes të Versajës një delegacion që përbëhej prej anëtarëve të Shoqërisë Kulturore Maqedono-Rumune të Bukureshtit e nga disa anëtarë të Këshillit Kombëtar të ish-Republikës së Pindit e Zagorit të cilët ishin arratisur dhe qëndronin si refugjatë në Itali. Ky delegacion u prit nga të gjithë përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, të cilëve ai iu paraqiti një memorandum të shoqëruar me një studim historiko-etnografik për ekzistencën e maqedo-rumunëve qysh nga kohët më të lashta e deri në përfundimin e Luftës I Botërore. Në atë memorandum kërkohej: A – autonomi për rajonin e Pindit (me 130.000 banorë), i cili thuhej se ishte i banuar tërësisht nga një masë homogjene e kompakte kuco-vllehësh. Theksohej se rajoni i Pindit, në të gjitha aspektet: historike, etnografike, ekonomike, strategjike e politike, i plotësonte kushtet e domosdoshme për ekzistencën e tij si entitet i pavarur.

B. Për grupet e tjera maqedo-rumune, si : - grupi i Manastirit me 83.145 vetë, grupi i Musakisë (Myzeqesë) – Korçës me 77.814 banorë, grupi i Veri-Meglinias (Selanik) me 10.3877 banorë dhe ai i Thesalisë me 81.520 banorë, kërkohej autonomi shkollore dhe eklesiastike dhe një regjim politik të përshtatshëm që do të siguronte një zhvillim të lirë të individualitetit të tyre etnik, nën kontrollin e Lidhjes së Kombeve dhe të Rumanisë, e cila do të autorizojë të subvenciononte institucionet kulturore dhe do të kishte të drejtë të ndërhynte për të respektuar të drejtat e arumunëve.<sup>42</sup>

Sipas autorëve të memorandumit, George – Murnu, Nicolae Taci, Arghir Culina dhe Tache Papahagi, kërkesat e parashtruara synonin zhvillimin e lirë etnik të elementit latin, që përfaqësohej nga maqedo-rumunët në Gadishullin Ballkanik; zhdukjen e armiqtësive dhe mosmarrëveshjeve politike dhe të luftës së kombeve në gadishull, si dhe krijimin e zhvillimin e një qytetërimi të vjetër në Orient<sup>43</sup>.

Gjithashtu, në memorandumin e Shoqërisë Maqedono-Rumune bëhej edhe një historik i shkurtër i lëvizjes politiko-kulturore arumune. Aty theksohej se Patriku i Stambollit, i cili ishte në shërbim të panhelenizmit, luftoi për ta dobësuar kulturën kombëtare të kuco-vllehëve. Kështu lëvizjet për zgjimin patriotik të fundit të shekullit XVIII e fillimit të shekullit XIX që drejtoheshin nga Roza, Kavaloti, Ukuta dhe Bojaxhiu, u luftuan dhe u shtypën. Por gjysmë shekulli më vonë, ideja kombëtare doli sërish në shesh. Në vitin 1862 u krijuan shkolla rumune në Maqedoni e Epir. Ato ndeshën sërish në kundërshtimin e rreptë të Patriarkanës greke e të klerit grek, të cilët përdorën të gjitha mjetet që kishin në dorë. Memorandumi denonconte me forcë shtypjen e lëvizjes patriotike arumune nga grekët, duke nënvizuar se “për 50 vjet me radhë u bënë shtypje, kallëzime tek qeveria turke, vrasje, therje, martirizime e keqbjërje të tjera, të

<sup>42</sup> *Po aty.*

<sup>43</sup> *Po aty.*

sokëllimta, dhe mizori, që nuk rrefehen, nga andartë të ardhur prej Greqisë e të mbajtur prej propagandës helenike. Kurrë nuk është bërë ndonjë kryqëzatë me aq egërsi të tërbuar. Mjafton të përmendim se gjatë 2-3 viteve mbi 400 vetë nga paria rumune gjetën vdekjen sepse nuk iu nënshtruan urdhrave të ardhura prej komiteteve terroriste greke, që t'i largonin djemtë e tyre nga shkollat kuco-vllehe<sup>44</sup>.

Në memorandumun e sipërpërmendur vihej në dukje se, pas Luftërave Ballkanike “ditë më të zeza shkrepën për kuco-vllehët. Traktati i Bukureshtit i jepte ata si tufa delesh në dorë të Serbisë, të Greqisë e një pakicë në dorë të Bullgarisë. Këto qeveri i premtuan qeverisë rumune se do t'i garantonin elementit arumun njëfarë autonomie kulturore. Por këto garanci mbetën letër e vdekur. Kur filloi Lufta e I Botërore, turqit, bullgarët, serbët dhe grekët i futën kuco-vllehët me pahir nëpër ushtritë e tyre, megjithëse ata s'kishin asnjë interes të merrnin pjesë në këtë luftë. Kështu që u vranë për interesa të huaja.

Memorandumi theksonte se, meqë nuk formonin një masë të bashkuar e kompakte, arumunët nuk mund të aspironin për të krijuar një shtet të tyre. Gjithashtu, meqë gjeografikisht nuk mund të bashkoheshin me Rumaninë, maqedo-rumunët e katër shteteve ballkanike zgjidhnin Shqipërinë, me të cilën kërkonin të bashkoheshin. Arsyeja ishte se “rumunët e shqiptarët kishin jetuar së bashku dhe kishin pasur gjithmonë marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin edhe për arsyen se tek shqiptarët s'gjen fare shovinizëm e eskluzivizëm, të rrënjosura tepër nëpër popujt e tjerë ballkanas<sup>45</sup>. Kështu që “kuco-vllehët luteshin e faleshin për një zgjerim të Shqipërisë sa më tepër që të ishte e mundur, që ajo të përfitojë shumicën e Vilajetit të Manastirit, ku pothuajse nuk ka fare serbë, Pindin e më të shumtën e Epirit, që është vetëm shqiptar<sup>46</sup>.

Përkrahës i këtij projekti ishte edhe shkrimtari me origjinë vllehe, Nikolla Jorga. Ai pohonte se vetëm nëpërmjet zotërimit italian do të arrihej një bashkëpunim midis shqiptarëve dhe vllehëve të Pindit. Ky bashkëpunim do të ishte siguria më e fortë për të ardhmen, që të dy kombet, të cilët ishin shumë të dobët për të pasur mundësi të jetonin veç e veç, të zhvilloheshin e të sprapsnin rreziqet. Sipas Jorgës “garancia italiane”, apo siç theksonte ai, zotërimi italian “kishte për të sprapsur ndonjë shmangie të mundshme të njërit apo tjetrit komb nga një gjendje që e ëndërronin, e cila nuk është krejtësisht e realizueshme<sup>47</sup>.

Memorandumi i delegacionit meqedono-rumun, i cili përbëhej nga Murnu, Taçi, Kulina dhe Taqi Papahaxhi, iu paraqit Konferencës së Paqes në mars të vitit 1919. Ai shkaktoi zemërim tek Delegacioni grek. Kështu që

<sup>44</sup> “Kuvend’ i Paqes”, *Kuvendi*, 10 mars 1919; “Memorandum of the Macedonian-Roumanians to the Peace Conference”, *The Adriatic Review*, Mars 1919.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> *Po aty*; “A Memorandum of the the Macedonian-Roumanians to the Peace Conference”, *The Adriatic Review*, Mars 1919.

<sup>47</sup> “Zoti Nikolla Jorga për shqiptarët”, *Shqipëri e Re*, Bukuresht, 10 tetor 1919.

delegati i Rumanisë, N. Misho deklaroi se ata që përbënin këtë delegacion përfaqësonin vetëm veten e tyre<sup>48</sup>.

Mirëpo disa muaj më parë diplomacia rumune, ndonëse nuk e kishte mbështetur këtë kërkesë, në një farë mënyrë e kishte justifikuar atë. Ministri i Rumanisë në Romë, A. E. Lahovary, kishte treguar një simpati të qartë për këtë projekt kur vinte në dukje se shqiptarët dhe arumunët kishin qenë më parë popuj të shtypur dhe kishin jetuar në harmoni me njëri-tjetrin, dhe se, meqë shqiptarët ishin miqtë e Italisë, “atëherë miqtë e miqve tanë, janë miqtë tanë”<sup>49</sup>. Ministri rumun vinte në dukje se Italia i kishte përdorur kurdoherë arumunët e Shqipërisë për influencën e saj kulturore dhe ekonomike në Ballkan. Ai e konsideronte të vështirë grumbullimin e kucovllehëve sepse ata ishin të përhapur në vende të ndryshme larg njëri-tjetrit. Por ai mendonte se ishte e mundur që grumbujt kryesorë ose më të mëdhenjtë duhej të gjendeshin në Shqipëri nën mbrojtjen e Italisë<sup>50</sup>. Ai e justifikonte këtë ndryshim të politikës rumune me faktin, se Serbia dhe Greqia, me të cilat Rumania kishte nënshkruar Traktatin e vitit 1913, nuk e kishin respektuar këtë traktat. Kërkesa, që rumunët e Pindit i bënë Konferencës së Paqes për t’u bashkuar me Shqipërinë, cilësohej si një provë e trajtimit jo të mirë të tyre nga Greqia. Megjithëkëtë, ministri rumun pohonte se Rumania kërkonte ende respektimin e neneve të atyre traktateve, që parashikonin “autonomi të gjerë nga pikëpamja e idealit të racës, shkollës e kishës” dhe kjo ishte e mjaftueshme<sup>51</sup>.

Historiografia greke i ka paraqitur në një dritë tjetër ngjarjet dhe lëvizjet arumune. Diomidis pohonte se propaganda italiane dhe shqiptare e organizuar nga Konsullata Italiane në Janinë ishte aktive edhe në territorin grek. Qëllimi i saj kryesor ishte të krijonte ndjenja antigreke midis minoritetit kucovlleh të Pindit e të Korçës<sup>52</sup>. Sipas tij, megjithëse lëvizja rumanizuese e shekullit XIX ishte braktisur, Rumania ende ruante një shpresë të vakët se kucovllehët një ditë, të paktën do t’i shërbenin si një mjet për të siguruar lëshime diku gjetkë. Kështu, në qershor të vitit 1917, qeveria italiane u kërkoi rumunëve të dërgonin në Maqedoni dhe në Epir 100 oficerë civilë me origjinë vllehe, për të zhvilluar propagandë antigreke e antiserbe. Kryeministri rumun, Bratianu, pas ndërhyrjeve të ashpra të qeverive franceze e britanike, vendosi ta hidhte poshtë kërkesën italiane.<sup>53</sup> Gjatë kësaj kohe, theksonte Diomidis, italianët vijuan të nxisnin një lëvizje kucovllehe. Në rajonin e Epirit, që ishte nën kontrollin e tyre, ata mbajtën dhe furnizuan një kompani të veçantë e të pavarur me 70-80 kucovllehë.<sup>54</sup> Agjentët e tyre në

<sup>48</sup> “Zoti N.Nisho dhe vllaho-maqedonasit”, *Shqipëri e Re*, Bukuresht, 17 shtator 1919.

<sup>49</sup> *Kuvendi*, 16 prill 1919.

<sup>50</sup> *Po aty*.

<sup>51</sup> *Po aty*.

<sup>52</sup> N. Petsalis-Diomidis, *vep. e përm.*, f.17-28.

<sup>53</sup> *Po aty*, f.52; Foreign Office (më tej: FO) 371/2889.

<sup>54</sup> *Po aty*, f.83.

Bukuresht inkurajuan kucovllehët e rumanizuar që të përfshiheshin në një Shqipëri të zmadhuar nën protektoratin Italian, e cila ishte zgjidhja më e mirë për vllahët. Ambasada italiane nxori pasaporta dhe ndihmoi arumunët të shkonin në Pind, ndërsa në shtypin rumun u shfaqën shumë artikuj të nxitur nga italianët<sup>55</sup>.

Një artikull në Vestea, në janar 1919, theksonte se kucovllehët e Pindit kishin shpallur pavarësinë e tyre me anë të një Këshilli prej 4 anëtarësh në Konicë dhe se ishte krijuar një ushtri vullnetare prej 10.000 vetësh. Mbështetja italiane për krijimin e Vllahisë së Madhe thuhej se ishte siguruar. Më tej Diomidis pohonte se “Vëllazëria Arsimore Maqedono-Rumune”, e kryesuar nga Gradisteanu, një ish ministër dhe mik i Joneskut, dërgoi një delegacion prej dy anëtarësh në Paris për të paraqitur një peticion, në të cilin kërkohesh që shumica e Epirit, Pindit dhe një pjesë e Manastirit (ku pretendohesh se jetonin 80.000 kucovllehë), ose t’i jepej Shqipërisë ose t’i akordohej një autonomi administrative, arsimore e fetare, me përfaqësimin e kuçovllehëve në parlamentet e shteteve ku gjendeshin këto territore. Diomidis thekson se Bratianu nuk kishte ndonjë iluzion për efektivitetin e përpjekjeve të kucovllehëve, por nuk i kundërshtoi aktivitetet e tyre, sepse nuk donte që t’i zemëronte italianët.<sup>56</sup> Si rezultat i protestave të qeverisë greke, Ferkydi (presidenti i kabinetit rumun) deklaroi se e vetnja gjë, që donte qeveria e tij, ishte liria fetare dhe arsimore e elementit arumun në Epir e Maqedoni, në përputhje me Traktatin e vitit 1913 të Bukureshtit. Ai deklaroi se Rumania dëshironte të mbetej në marrëdhënie miqësore me Greqinë e Italinë dhe nuk donte të përfshihej në grindjet italo-greke<sup>57</sup>. Propaganda kucovllehe në Rumani vazhdoi për disa muaj, pa arritur të sjellë çështjen vllehe në fokusin e Konferencës së Parisit.

Më tej pas Luftës së Parë Botërore vllahët u përfshinë në shkëmbimin e popullsisë midis Greqisë e Turqisë dhe Greqisë e Bullgarisë dhe gjithashtu pati lëvizje të vllahëve drejt Rumanisë. Afër Liqenit të Prespës disa vllahë nomadë nga Shqipëria u vendosën në vendet bosh të lëna nga turqit.

Në periudhën midis dy luftërave botërore, Greqia e Jugosllavia, jo vetëm që nuk i respektuan angazhimet e marra në Traktatin e Bukureshtit të 13 qershorit të vitit 1913, por as që njohën ndonjë të drejtë të komunitetit maqedono-rumun. Shkollat rumune u paralizuan për hesap të shkollave greke që u çelën në qendrat rumune. Po në të njëjtën mënyrë u veprua edhe me kishën rumune. Qeveria jugosllave asnjëherë nuk i toleroi, as komunitetin arumun, as shkollat, as kishat dhe asnjë manifestim arumun, siç ishte përcaktuar në

<sup>55</sup> *Po aty*. (Autori i referohet arkivit grek YE-A/5 II, Pallis për Diomidis, tel.3970).

<sup>56</sup> *Po aty*. (Autori i referohet arkivit grek, YE-A/5 VIII Dendramis për Diomidis, desp. 45, 18 janar 1919 dhe tel. 123, 25 janar 1919).

<sup>57</sup> *Po aty*, f.84. (Autori i referohet arkivit grek, YE-A/5 VIII Dendramis për Diomidis, telegramet 129 dhe 165 me 7 dhe 12 shkurt 1919).

Traktatin e Bukureshtit. Një përjashtim u bë vetëm për kishën e komunitetit arumun të Manastirit deri në vitin 1939. Në këtë vit, Metropolitan Platoni dhe drejtuesit e autoriteteve civile e ushtarake e konfiskuan këtë kishë si dhe lokalet e Liceut rumun të Manastirit e madje edhe varrezat ku preheshin martirët arumunë bashkë me të shquarin Apostol Margariti dhe me shumë heronj të tjerë arumunë që kishin rënë në frontin e luftës së Antantës në Lindje<sup>58</sup>

Pikëpamje më realiste mbi zgjidhjen e çështjes së vlllehëve në Shqipëri kishte kapiteni britanik J. S. Barnes, i cili pohonte se kishte një popullsi vllhe e cila e kishte identifikuar veten në të gjitha drejtimet me shqiptarët, me përjashtim të gjuhës. Sipas tij, këto vllhë nuk duheshin ngatërruar me vllhët helenofilë të Pindit<sup>59</sup>. Ai sugjeronte që vllhët e Gramozit të përfshiheshin në shtetin grek sepse kështu nuk do të kishte një copëtim definitiv të masës kompakte të vlllehëve që banonin në këtë rajon, dhe kështu, ata nuk do të ndaheshin nga vllhët e Pindit “të cilët ishin subjekte luajale” të Greqisë. Gjithashtu, sipas tij, interesi i Greqisë dhe i Shqipërisë për t’u bërë miq të ngushtë politikë, kërkonte që të mos vendosej një kufi në mesin e një populli, i cili, pas një farë kohe, ishte i prirur të mbronte i bashkuar traditat e veta racore. Vllhët e këtyre rajoneve nuk mund të shpresojnë apo të duan të formojnë një shtet të veçantë, por ata mund të presin të fitojnë një status special dhe privilegje. Sipas Barnesit problemi nuk ishte i ndryshëm nga problemet e tjera nacionale dhe historia kishte provuar se në këto probleme, rregulli i parë për të krijuar stabilitetin ndërkombëtar ishte unifikimi kombëtar. Prandaj, ishte e padiskutueshme që nuk mund të bashkohej e gjithë kjo popullsi në Shqipëri. Ajo mund të realizohej vetëm duke dhunuar unitetin kombëtar grek. Nga ana tjetër, bashkimi i tyre në Greqi ishte përsosmërisht i lehtë.

Në të njëjtin artikull thuhej se mbeturinat e shpërndara të kësaj race në Shqipërinë e Jugut ishin një minoritet shumë i vogël e i papërfillshëm, që në qoftë se do të shfaqnin dëshirën për t’u bashkuar me vëllezërit e tyre, nuk do të krijonin ndonjë shkak për turbullira serioze. Përkundrazi, kishte shumë të ngjarë, që ata të shërbenin si një mjet i dobishëm për konsolidimin e interesave greko-shqiptare. Në të njëjtën kohë nuk duhej harruar se vllhët e Malit Gramoz, aktualisht ishin fuqimisht proshqiptarë, ndoshta për arsye të tendencave të tyre pan-latine, të cilat do të gjenin mbështetje e simpati nga toskët shqiptarë dhe një udhëheqje nga Italia, influenza e së cilës do të ishte primare në Shqipëri në raport me ndonjë fuqi tjetër<sup>60</sup>.

<sup>58</sup> *Sguardo Retrospectivo ...*, f.15.

<sup>59</sup> J.S. Barnes, “The Future of the Albanian State”, *The Adriatic Review*, tetor 1918.

<sup>60</sup> *Po aty*.

### **Mendimi shqiptar për bashkëjetesën me vllahët në fazën e parë të ndërtimit të shtetit shqiptar**

Mendimi i inteligjencies dhe personaliteteve politike shqiptare lidhur me minoritetet në Shqipëri është pasqyruar gjerësisht në faqet e shtypit shqiptar, në botimet apo pamfletet e ndryshme politike, në memorandumet dërguar institucioneve ndërkombëtare, etj.

Në momentet kur çështja shqiptare po diskutohej në Konferencën e Paqes, gazeta e shqiptarëve të Italisë, “Kuvendi”, nënvizonte edhe rëndësinë e përkushtimit të shqiptarëve ndaj mirëtrajtimit të minoriteteve. Ajo shkruante: “E pjekur nga vuajtjet e saj, Shqipëria, kur të ndërtohet, do ta ketë si detyrë të rrojë në bashkim të përkryer, me një frymë të gjerë durimi, duke u dhënë pakicave të huaja të gjitha të drejtat që ato i kanë gjetur në vendet e përparuara”<sup>61</sup>.

Ndërsa, diplomati dhe patrioti i njohur Mehmet Konica, pasi vinte në dukje se Pindi banohej ekskluzivisht prej kucovllehëve të cilët ishin pasardhës të kolonëve antikë romakë dhe blegtorë që vinin të dimëronin tufat e tyre të bagëtive në kullotat e Shqipërisë bregdetare, sugjeronte që ata duhej të zgjidhnin me vullnet të lirë, nëse do të jetonin në përbërje të shtetit shqiptar apo të shtetit grek.<sup>62</sup>

Kryetari i Dërgatës Shqiptare në Konferencën e Paqes njoftoi Komitetin e të Dhjetëve për dëshirën që kishin shfaqur arumunët e Pindit për t’u bashkuar me Shqipërinë. Ndërsa Ministri i Jashtëm Mehmet Konica deklaronte se “rumunët e Pindit, shumë krerë të të cilëve gjenden prej kohësh në tokën shqiptare, duan të shkundin zgjedhën greke e të bashkohen me Shqipërinë. Delegatë të zgjedhur prej këtij vendi do të shkojnë në Paris për t’ia paraqitur dëshirën e tyre Konferencës së Paqes, të kuturisur të mos u ndahen të drejtave të tyre, veçse me forcë. Ne e shohim vetëm me simpati këtë lëvizje, së cilës jemi gati t’i kushtojmë përkrahjen tonë të vërtetë e vëllazërore”<sup>63</sup>.

Qarqet diplomatike greke nxituan t’i kundërshtonin deklaratat e Ministrin të Jashtëm shqiptar, duke i cilësuar të pabazuara, pasi kucovllehët që i kishin dhënë helenizimit burra si Averofi me shokë, nuk do të kërkonin shkëputjen nga Greqia mëmë e bashkimit të tyre me Shqipërinë.<sup>64</sup>

Mirëpo maqedo-rumunët që jetonin në Rumania i dërguan një memorandum Komitetit të të Dhjetëve, në të cilin kërkonin, në emër të gjithë vllahëve, bashkimin e tyre me Shqipërinë e re. Gazeta Kuvendi, e quante këtë

<sup>61</sup> “Ekspozicioni i përshpagimeve shqiptare përpara Komitetit të të Dhjetëve”, *Kuvendi*, 16 prill 1919.

<sup>62</sup> Mehmet Konica, “The Albanian Question”, *The Adriatic Review*, vol.I, nr.4, dhjetor 1918.

<sup>63</sup> “Kuvend’ i Paqes”, *Kuvendi*, 10 mars 1919.

<sup>64</sup> *Po aty*.

memorandum “një titull nderi për kombin shqiptar”<sup>65</sup>. Gazeta theksonte se e përkrahte çështjen e vlllehëve, jo pse ata kërkonin bashkimin me Shqipërinë por sepse përpjekjet e tyre synonin të siguronin ekzistencën kombëtare të ruajtur gjer më sot me të keq e me trimëri, por padyshim në rrezik që të humbasë në qoftë se popullit kuco-vlleh Konferenca nuk do t’i plotësonte kërkesën e tij të shfaqur në Konferencën e Londrës të vitit 1913 dhe që përsëritej në memorandum aktual<sup>66</sup>. Kuvendi shkruante se çështja e rumunëve të Pindit nuk ndryshonte fare nga çështjet e tjera kombëtare të çdo populli që ishin shtruar para Konferencës së Paqes, e cila duhej t’i jepte asaj një zgjidhje në mënyrë që të mos shkelte parimet e saj të lirisë dhe të vetëvendosjes. Ajo i paralajmëronte arumunët që të tregoheshin energjikë e të lëviznin, sepse ndryshe mundësitë e fitores së çështjes së tyre mund të pakësoheshin, si rezultat i kundërshtimit dinak që, sigurisht, do t’i bënin grekët e serbët.

Kuvendi bënte thirrje për forcimin e solidaritetit dhe bashkëpunimit shqiptaro-vlleh. Shqiptarët dhe vlllehët, për t’ia arritur qëllimit të shenjtë, lipsej t’i jepnin bashkëpunimit të tyre një fytyrë praktike e pozitive. Ajo u bënte thirrje edhe vlllehëve të Amerikës, të cilët ishin të organizuar e mund të punonin lirisht, të ngrinin zërin e tyre në Paris, pasi ata, së bashku me shqiptarët e atjeshëm, mund t’i sillnin çështjes shumë shërbime të mëdha<sup>67</sup>.

Kërkesa e vlllehëve të Pindit për t’u bashkuar me Shqipërinë i shërbeu mjaft, si një mbështetje morale, delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes për të kundërshtuar politikën aneksioniste greke ndaj Shqipërisë së Jugut. Kryetari i qeverisë Shqiptare Turhan Pasha, në ekspozenë që i parashtrroi Konferencës për çështjen shqiptare, theksonte: “Ende vlllehët e krishterë duan t’i bashkohen Shqipërisë. Në një kohë kur kundërshtarët tanë pretendojë se shqiptarët e Epirit të Veriut dëshirojnë të bashkohen me Greqinë, vlllehët e Pindit, të cilët tashmë e kanë njohur mirë administratën greke, duan të bashkohen me Shqipërinë. Si është e mundur të pranojmë se ka shqiptarë të cilët duan të ndahen nga vëllezërit e tyre, kur një element i huaj, siç janë vlllehët, që kanë jetuar nën regjimin grek, kërkojnë të bashkohen me shqiptarët?”<sup>68</sup> Kryeministri i Shqipërisë vinte në dukje se “Shqipëria, e pjekur nga vuajtjet e saj, kur të konstituohet si shtet, do të bëjë detyrën e saj që të jetojë në një bashkëjetesë të përkryer me shpirtin e një tolerance të madhe, duke u garantuar minoriteteve të huaja të gjitha të drejtat që u janë njohur atyre në vendet më të zhvilluara të botës”<sup>69</sup>.

<sup>65</sup> *Po aty*.

<sup>66</sup> *Po aty*.

<sup>67</sup> “Çështja e Vlllehëve të Maqedonisë”, *Kuvendi*, 18 mars 1919.

<sup>68</sup> Turhan Pasha, “The Expose of Albanian Demands Before the Peace Conference”, *The Adriatic Review*, prill 1919.

<sup>69</sup> *Po aty*.

Gazeta kryesore e kohës, “Dielli”, e cila përfaqësonte pikëpamjet e organizatës më të fuqishme patriotike shqiptare, Federatës “Vatra”, e vlerësonte lart bashkëjetesën dhe trajtimin liberal të minoriteteve nga shqiptarët. Duke përshëndetur memorandumin e shoqërisë maqedo-rumune dërguar Konferencës së Paqes, gazeta shkruante se ai “ka një vlerë karakteristike për të drejtat që kërkojnë shqiptarët nga Konferenca e Paqes. Vëllezërit tonë vllëhë i ndihmojnë të drejtat tona me këtë veprim, gjë e cila do të bëjë një përshtypje të madhe në pjesëtarët e konferencës. Ajo i kalbëzon nga rrënja të gjitha shpifjet dhe kallëzimet serbo-greke, me qëllim që t’i diskreditojnë shqiptarët përpara opinionit publik të përbotshëm si të paqytetëruar”. Më tej, thuhej se “Kucovllëhët e Manastirit dhe të Pindit, jo vetëm që kanë provuar vëllazërimin e tyre me shqiptarët, por do kenë lumturinë të gëzojnë gjithë liritë politike dhe njerëzore në shtetin shqiptar, sepse shqiptarët, si adhurues të lirisë, janë respektues edhe për lirinë e të tjerëve”. Kërkesën e shoqërisë maqedo-rumune për t’u bashkuar me shtetin shqiptar, “Dielli” e cilësonte si “një provë të qartë, e cila tregonte se shqiptarët janë komb më i qytetëruar se serbët dhe grekët, të cilët përpiqen “të thëthinë elementët e ndryshme dhe të majmen me mishin e të tjerëve. Ndërsa shqiptarët dëshirojnë t’u japin lirinë çdo elementi që mbetet në pakicë në tokën shqiptare”. Kështu, kufijtë, që kërkoi delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes, ishin të drejtë, sepse pakicave rumune e bullgare që do të mbeteshin brenda tyre, u shpreh “ne jemi gati t’u japim çdo siguri për lirinë dhe zhvillimin e tyre kombëtar”<sup>70</sup>. Vllëhët cilësoheshin si një element i dobishëm që kishin luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregtisë gjatë periudhës osmane, të cilët me përvojën e tyre do të kontribuonin edhe për zhvillimin e tregtisë në shtetin e ri shqiptar. U kërkohej vllëhëve në SHBA që ta mbështesnin memorandumin e shoqërisë maqedo-rumune dhe t’i dërgonin telegrame Konferencës së Paqes, duke kundërshtuar politikën e Venizellosit, i cili po përpiqej t’ua mohonte kombësinë e tyre. Madje, e njëjta gjë, u kërkohej edhe izraelitëve të Janinës dhe veçanërisht emigrantëve izraelitë të New Jorkut të cilët duhej t’i kërkonin Konferencës bashkimin me Shqipërinë<sup>71</sup>.

Ndërsa në prag të Konferencës së Paqes, Kleri i Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës denoncoi politikën shtypëse të qeverisë greke kundrejt arumunëve të Pindit të cilët, qysh nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, po u kërkonin Fuqive që të bashkoheshin me Shqipërinë, me qëllim që t’i shpëtonin keqtrajtimit dhe shtypjes greke<sup>72</sup>. Mendohej se, kështu, do të vepronin edhe

<sup>70</sup> *Po aty.*

<sup>71</sup> *Po aty.*

<sup>72</sup> Memorandum mbi Shqipërinë nga Kleri i Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës, dërguar Presidentit Wilson, 27 nëntor 1918, *The Adriatic Review*, Vol.I, nr.3, nëntor 1918.

bullgarët e Maqedonisë Perëndimore të cilët nuk do të hezitonin të integroheshin në Shqipëri, në qoftë se atyre do t'u jepej si alternativë përfshirja në Greqi ose në Serbi<sup>73</sup>.

Ndërsa Sevasti Qiriazi dhe Dhimitër Bala, dy intelektualë dhe aktivistë të shquar të çështjes kombëtare shqiptare në SHBA, theksonin se “shembulli më i mirë që ilustron qëndrimin liberal të shqiptarëve kundrejt popujve fqinj, është besimi, që kanë treguar qysh në kohët e lashta vllahët, të cilët e shprehën besimin e tyre gjatë Konferencës së Londrës, së cilës i kërkuan që të jetonin në një shtet me shqiptarët”<sup>74</sup>.

### *S u m m a r y*

#### THE ETHNO-CULTURAL MINORITY OF VLACHS DURING 1912-1920

The Vlachs are one of the ethno-cultural minorities that are distinguished for the warm relations with the Albanian populations and comprise an excellent historical model of the harmonic coexistence. Feeling that their identity was better protected in the frame of the Albanian state the Vlachs demanded in the London Conference that the territories inhabited by them to be included in this new state. In this manner they intended to be rescued from the harsh assimilating Greek and Serbian policies. This demand was also supported by the Romanian government. The Greek government demanded that the Aromanians of Pindus to be included in the Greek state by promising that Greece would give the guarantees for the conservation of their ethnic identity. The same promise was made by Serbia for the Vlachs of Macedonia. However, these commitments were never maintained from these two states. The armed bands entered in south Albania and massacred some of the leaders of the Vlach community.

Another alternative demand of the Vlachs was the creation of an Albanian-Macedonian state within which they hoped to ensure an independent life.

In difference from the Balkanic state that pursued violent assimilating policies toward the Vlachs, in Albania there were not demonstrated such policies. Nevertheless, in the Congress of Trieste between the Albanian and the Vlachs delegates there were some polemiques because the Vlachs presented some maximalist demands for territorial autonomy within the Albanian state like the one the Czechs had in Austria-Hungary. This demand was contested by the Albanian delegates, which emphasised that the Vlachs of Albania did not comprise compact bodies in order to form cantons.

However, these were isolated appearances and the relations remained friendly. Thus also in the Peace Conference of Versailles in 1919, the Vlachs again demanded as an alternative solution their joining with the Albanian state.

Also in Albanian press with the exception of any isolated case, almost the whole of it has echoed the friendship with the Vlachs by describing them often as brothers or as comrades in arms for the independence with Albanians.

---

<sup>73</sup> *Po aty.*

<sup>74</sup> Sevasti Dako, Dimitri Bala, “Albania’s Rights, Hopes and Aspirations”, *Yll’ i Mëngjezit* (The Morning Star) vol.3, nr.7, Boston Mass., nëntor 1918.